

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "AJMAEL" Sh.p.k.**

Sot, më datë 12 / 01 /2023,

- Znj. Mileva Sudar, shtetase shqiptare, lindur me 21/09/1967, ne Shijak, banuese ne Rruga "Mihal Grameno", P. 1, Sh. 1, K. 2, Ap. 4, Tirane, mbajtese e dokumentit me nr. personal G75921019E, madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "AJMAEL" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "AJMAEL" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Mihal Grameno", P.87/1, Shkalla 1, Hyrja 2, Ap.4, Zona Kadastrale 8190, Tirane.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.


**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Investime të ndryshme;
- Shitblerje dhe/ose qera të pasurive të paluajtshme, ndërmjetësim shitblerje dhe / ose qera, menaxhim pronash;
- Shërbime due diligence, vlerësimi dhe manaxhimi financiar;
- Studime tregu;
- Menaxhim dhe zhvillim projektesh;
- Shërbime juridike dhe ligjore.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërise të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike



shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 5.000.000 Lekë (pesë milion lekë) dhe është i përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Znj. Mileva Sudar**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 5.000.000 Lekë (pesë milion lekë) dhe 5.000.000 Lekë (pesë milion lekë) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legiislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

**Z. Elton Belba**, shtetas shqiptar, lindur më 16/06/1975, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. Personal H50616160U, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përbajtja e Akitit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Elton Belba** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

MILEVA SUDAR

*Mileva Sudar*

*M.Sudar*